



## GALERIA KOMBËTARE E KOSOVËS HAP THIRRJEN PËR PROGRAMIN VJETOR 2024

Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se Galeria Kombëtare e Kosovës ka hapur thirrjen për programin vjetor për vitin 2024. Thirrja është e hapur për propozime për ekspozita ndërdisiplinare (duke përfshirë mediumin e pikturës, skulpturës, grafikës, instalacionit, fotografisë, videos, performancës, etj.) si dhe për projekte edukativo-arsimore, hulumtuese, botuese, multimediale.

Ekspozitat/projektet mund të implementohen brenda ose jashtë objektit të GKK në koordinim dhe diskutim me stafin e galerisë.

Inkurajohen projekt propozimet nga artistë dhe kuratorë, organizata dhe komunitete kulturore (kontratat lidhen me individë), hulumtues dhe praktikues tjerë të arteve pamore. Aplikuesi/ja duhet të jetë qytetar/e i/e Republikës së Kosovës.

### Si të aplikoni?

Aplikacionet dorëzohen online në [info@galeriakombetare-rks.com](mailto:info@galeriakombetare-rks.com) si PDF, *Google Drive* ose *WeTransfer*.

*Opsionale:* Të dorëzohen fizikisht në adresën: Galeria Kombëtare e Kosovës, Rr. Agim Ramadani, nr. 360, 10000 Prishtinë çdo ditë pune nga ora 10:00 – 16:00.

Materialet dhe dokumentet e nevojshme për aplikacion:

- Formulari i plotësuar të cilin mund ta gjeni [këtu](#).
- Projekt propozim (max. 1000 fjalë) ku sqarohet vizioni/qëllimi i projektit/ekspozitës, detajohet formati (instalacion, video, performancë, skica, animacion 3D, fotografi, etj.)
- Reproduksion vizual (fotografi, video, skica, animacion) i punës dhe vizualizim i vendosjes së punës në muret e galerisë (e preferueshme). [Këtu](#) gjeni udhëzuesin teknik dhe planin e hapësirave ekspozuese në GKK.
- Portfolio
- Biografi dhe CV, ose Webfaqe
- Dokument identifikues i Republikës së Kosovës
- Buxheti
  - Për ekspozita dhe punë artistike: Buxheti i parashikuar në linja vetëm për prodhimin e punës (Deri në 10,000 EUR.)
  - Për projekte tjera: Buxheti i parashikuar në linja të ndara për secilin aktivitet dhe i specifikuar në kohë.
- 

*Buxhetet do të negocohen dhe finalizohen sipas mundësive dhe kërkesës pas përzgjedhjes së projekteve.*

- Propozim për timeline/orarin e implementimit të aktiviteteve të projektit.

*Shënim:* Nuk pranohen punimet fizike (piktura, skulptura, të tjera).

Periudha e aplikimit: **20.10 - 20.11.2023**

Shpallja e projekteve të përzgjedhura: 10 janar, 2024

**Ku të marrim më shumë informata?**

Personi kontaktues në GKK për këtë aplikacion:

Shkamb Jaka, +383 (0) 38 225 627 / +383 (0) 45 640 410 ose në [info@galeriakombetare-rks.com](mailto:info@galeriakombetare-rks.com)

**Juria/Këshilli i GKK-së:** Renea Behluli, Agron Blakçori, Arlinda Hajrullahu, Artrit Bytyçi, Guri Çavdërbasha, Somer Şpat, Linda Gusia.